



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:257658
Datë: 19.09.2024
Numri i dokumentit: 06184497

C-IV-14-6479

Ankuesi:

Z M përfaqësuar nga av. B I, Prishtinë.

Kundër

Pala kundërshtare:

N.SH “Klina”, të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.05 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Nuk caktohet taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.10 tetor 2014, ankuesi parashtrij ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit: Vendimit PEJ137-0070 të datës 22 korrik 2014, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim për paga të pa paguara në shumë prej 6,690.00€, kontribute pensionale në shumë prej 696.00€, për periudhën prej 14.09.1994 deri më 01.07.1999, si dhe 10% interes në shumë prej 765.60€, në shumë totale prej 8,421.60€ nga N.SH “Klina” (në likuidim). Së bashku me ankesën ai ka bashkëngjitur kopjen e vendimit të kundërshtuar, Deklaratë e punëtorit, Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënie të punës, Kopja e librezës së punës.

Me dt.03 nëntor 2023, gjykata lëshoi vërejtje për pagesën e taksës gjyqësore. Ankuesi u njoftua se nëse nuk e bënë pagesën e taksës gjyqësore në afat prej 15 ditëve atëherë ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Vërejtja është pranuar nga i autorizuari i ankueses me dt.10 nëntor 2023 por, deri në kohën e përpilimit të vendimit nuk i është përgjigjur të njëjtës.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankueses konsiderohet e tërhequr.

Sipas neni 76 par.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: “Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë *mutatis mutandis* dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”

Ankuesja konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së *ka për detyrë që ankesës t’ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.*

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, pasi që shqyrtoi ankesën e dorëzuar dhe shkresat e tjera të lëndës, për arsye se nuk është paguar taksa gjyqësore përkundër vërejtjes së pranuar, konstatoi se ankesa duhet të konsiderohet e tërhequr.

Me dt.03 nëntor 2023, Gjykata përmes vërejtjes kërkoi nga ankuesi që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e tij do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk përgjigjet në vërejtjen e lëshuar nga gjykata. Ankuesi është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore, por se i njëjti nuk i është përgjigjur vërejtjes së gjykatës.

Duke u bazuar në nenin 10 par.10.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 të KGJK-së, në përputhje me paragrafin 4 të Vendimit të KGJK-së nr. 25 të datës 5 mars 2014 por edhe bazuar si dhe nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017, i cili ka hyrë në fuqi më 01 maj 2017, për aplikimin e njëjtë të taksave gjyqësore, Paditësit i kërkohet që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga të shërbyerit dhe pranimi i vërejtjes së gjykatës për t’ia dorëzuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës vërtetimin dhe faturën e pagesës të shumës së caktuar që duhet paguar.

Megjithatë, paditësi mund t’i dorëzojë gjykatës prova në lidhje me faktin se ai është i liruar nga pagesa për arsye se është përfitues i ndihmës sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose Ndihmës Ligjore nga Zyra e Qarkut për Ndihmë Juridike.

Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017, për unifikimin e tarifave gjyqësore, neni 5 par. 5.1, parashikon detyrimin e të gjithë atyre që i drejtohen Gjykatës për të paguar taksat gjyqësore për procedimin në shumën e duhur.

Ndërsa neni 5 par.5.2 parasheh që: "nëse pas njoftimit, pala nuk i paguan taksat gjyqësore, sipas nenit 5.1 të këtij udhëzimi, gjyqtari i caktuar për çështjen, do të aplikojë nenin 253, paragrafi 5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe si pasojë padia do të konsiderohet e tërhequr.

Rrjedhimisht, neni 253 par.5 i Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore përcakton se: 'Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr'.

Nga kjo gjykata konsideron se ankuesi nuk ka interes për çështjen juridike të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore ankesa konsiderohet e tërhequr.

Shpenzimet Gjyqësore

Duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrie Shala